

KËRKESË
Nr. 3980, datë 20.7.2015

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken si rezultat i realizimit të projektit "Ndërtimi i linjës së re të ujësjellësit të Durrësit", në zonën e Adriatikut, të Fushë-Milotit dhe të Durrësit. Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizime. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përlllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar, për pronarët emërorë sipas listës bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet vetëm për pasurinë e llojit "tokë bujqësore".

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik".

Vlera totale e shpronësimit është 1 312 500 (një milion e treqind e dymbëdhjetë mijë e pesëqind) lekë.

**MINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS**
Edmond Haxhinasto

Tabele: Lista e Pronareve qe do te shpronsohen nga ndertimi i Ujesjellesit (Vend burimi Fushe Milot)

Nr	Komuna / Fshati	Emertimi i Pusit	Emer Mbiemer i Pronarit	Nr. I parcelës	Nr. Kadastres	Nr. Pronarve	Statusi Ligjor i Pronësisë	Tipi i Tokës	Sipërfaqe totale (m2)	Vlerësimi i Sipërfaqes për Shpronësim (m2)			
										Sipërfaqe qe shpronësohet (m2)	Cnim (ALL / m2)	Vlera e Shpronësimit (ALL)	Statusi Ligjor në ZIRPP
1	Komuna Milot / Fshati Fushe Milot	FM - 1	Kol Marku (Frrok Marku dhe Danjel Marku sipas ligjit 7501)	35/27	1677	1	Pa regjistruar	Tokë Bujqësore	1400	625	350	218 750	Pa Regjistruar
2	Komuna Milot / Fshati Fushe Milot	FM - A	Ndue Lazer Mehilli	40/14	2580	1	Ne proces	Tokë Bujqësore	6700	625	350	218 750	Ne Proces
3	Komuna Milot / Fshati Fushe Milot	FM - 4	Loro Gjon Kolaj	38/17	1677	1	Regjistruar	Tokë Bujqësore	4000	625	350	218 750	Regjistruar
4	Komuna Milot / Fshati Fushe Milot	FM - B	Ismet Taf Veseli	43/2	1677	1	Regjistruar	Tokë Bujqësore	18000	312.5	350	109 375	Regjistruar
5	Komuna Milot / Fshati Fushe Milot	FM - B	Xhumalle Adbulla Veseli	43/44	1677	1	Regjistruar	Tokë Bujqësore	2016	312.5	350	109 375	Regjistruar
6	Komuna Milot / Fshati Fushe Milot	FM - D	Murat Hasan Veseli	42/26	1677	1	Regjistruar	Tokë Bujqësore	1850	625	350	218 750	Regjistruar
7	Komuna Milot / Fshati Fushe Milot	FM - E	Dervish Zenel Haxhiu (Te bijte: Alush Haxhiu, Kujtim Haxhiu sipas ligjit 7501)	43/19	1677	1	Ne proces	Tokë Bujqësore	11100	625	350	218 750	Ne Proces
TOTAL										3750		1 312 500	

